

Data 21.09.2023

**PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE  
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

**OBJEKTI I PROCEDURËS:** Materiale për rrjetin e ndriçimit

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):**

34928510-6 Shtylla për ndriçim rrugor

34993000-4 Ndriçues rrugor

**VLERA E FONDIT LIMIT:** 79.047.600 (shtatëdhjetë milion e dyzet e shtatë mijë e gjashtëqind) lekë pa TVSH.

Vlera e fondit limit në monedhën ndërkombëtare euro sipas kursit të Bankës së Shqipërisë është 744,117 (shtatëqind e dyzet e katër mijë e njëqind e shtatëmbëdhjetë) euro pa TVSH.

Kursi zyrtar i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë për monedhën euro në datë 21.09.2023 është 106.23.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor **Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndriçimit Publik** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

**I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

*a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 3;*

*b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, sipas shtojcës 8*

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

## **2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:**

### **2.1. Përshatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):**

1. Çertifikatë ISO 9001-2015 ose ekuivalent. (e vlefshme dhe e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë).

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a), nenin 79 të LPP, nenit 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar . Kjo çertifikatë është kërkuar me qëllim që operatorët ekonomikë që do të zbatojnë kontratën të jenë certifikuar në sistemin e menaxhimit të cilësisë. Certifikata duhet të jetë e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Nisur nga rëndësia, volumi i kontratës është e rëndësishme realizimi me sukses i kësaj procedure dhe operatorët pjesëmarrës të provojnë se kanë një sistem të menaxhimit të cilësisë duke demonstruar aftësinë e tyre për të ofruar vazhdimisht mallra që plotësojnë dhe garantojnë kërkesat e AK-së.

### **2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2020,2021,2022 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit. Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, pra sa vlera e fondit limit, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Autoriteti Kontraktor i është referuar VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", neni 43, pika 2, gërma a) dhe vlerën e xhiros minimale vjetore e ka përcaktuar brenda kufirit maksimal të lejuar nga ky nen.

*Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.*

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike".

*(Shënim: citoni dispozitën përkatëse të legjislacionit tatimor, ku përcaktohen afatet për paraqitjen nga tatimpaguesit të deklaratës vjetore pranë organeve tatimore).*

2. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2020,2021,2022 të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel të Autorizuar,

vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41 të Ligjit Nr.10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, të nenit 41 të Ligjit Nr.10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, në nenin 29, pika 1 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat" i ndryshuar si dhe kërkesave të Ligjit nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

*(Shënim: citoni dispozitën përkatëse të legjislacionit tatimor, ku përcaktohen rastet kur personat juridikë kanë detyrimin që të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabël ose shoqëri audituese).*

3. Deklaratë nga Operatori Ekonomik për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2023, ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar sipas Ligjit Nr.9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar. *(Në çdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime. Operatori ekonomik i kualifikuar i pari duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimin e shlyerjes së taksave vendore).*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, në nenin 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, në ligjin nr.9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 4, pika 2, gërma d) dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar.

Referuar sa më sipër, Autoriteti Kontraktor gjykon se kriteri i vendosur lidhur me dorëzimin nga ana e operatorëve ekonomikë të deklaratës për shlyerjen e detyrimeve vendore për vitin 2023 sipas kësteve pranë bashkisë/ve ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi e konkretisht me ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 për “Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar. Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendodhjen e aktivitetit të tyre dhe për t’iu nënshtuar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj.

## 2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 40 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

*Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme është vendosur brenda kufirit të vlerës të përcaktuar në rregullat e prokurimit publik dhe i shërben AK për të treguar se ofertuesit me kapacitetet e tyre kanë realizuar kontrata të ngjashme me objektin që prokurohet, në vlerë jo më të vogël se 40 % të fondit limit, në afat, me cilësi dhe rrit besueshmërinë mbi përvojën që ka ofertuesi në treg. Përvoja e ngjashme konsiderohet si kriter thelbësor dhe si rrjedhim operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi të tilla si referenca/fatura tatimore, për të provuar kryerjen e tyre qoftë me sektorin privat dhe atë publik.*

**Shënim:** Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkohet, autoritete/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të kontratave të ngjashme brenda këtij marzhi.

Shënim: Autoretiti /enti kontraktor mund të kërkojë edhe:

### 2.3. Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

2. Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim prodhuesi/distributori për mallrat, objekt prokurimi. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit/distributorit si: telefon, fax, e-mail, website kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.

**Argumentim:** Në bazë të pikës 4, të nenit 77 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pikën 6, të nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” me anë të këtij kriteri AK gjykon se autorizimi i prodhuesit ose distributorit të autorizuar është një dokument i rëndësishëm, pasi përveç se tregon origjinën e mallrave që kërkohen në procedurë, garanton se ofertuesi është i autorizuar për ofrimin tek AK të këtyre mallrave. Kjo garanci lidhet njëkohësisht edhe me treguesit cilësorë të mallrave që kërkohen të blihen e që janë prodhuar në përputhje me standardet. Ky kriter është në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe lidhet drejtpërdrejtë me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë e OE ofertues për aftësitë teknike. Kjo kërkesë i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së OE-se për përmbushjen me sukses të kontratës.

3. Operatori ekonomik duhet të paraqesë katalog ose/dhe skeda teknike për të gjithë mallrat objekt prokurimi, ku të jepen të gjitha karakteristikat teknike të tyre, me qëllim që autoriteti kontraktor të verifikojë përmbushjen e specifikimeve teknike. Paraqitja e shtojcës 5 “Formulari i specifikimeve teknike” si skedë teknike nga operatorët ekonomik pjesëmarrës, e firmosur dhe vulosur prej tyre do të vlerësohet e pavlefshme.
4. Operatori ekonomik duhet të paraqesë ofertën teknike, për të gjitha mallrat objekt prokurimi, në formën e një table sipas modelit të mëposhtëm, e cila duhet të plotësohet në mënyrë rigoroze. Oferta teknike duhet të përmbajë të dhënat si më poshtë;
  - a. Emri i kompanisë prodhuese
  - b. Emërtimi i Katalogut të prodhuesit ose i skedës teknike
  - c. Numri i faqes në katalog ose në skedën teknike ku ndodhet artikulli
  - d. Numri (kodi) identifikues i artikullit të ofruar, i shënuar me një shenjë dalluese.

Nr.	Emri i kompanisë prodhuese	Emërtimi i katalogut të prodhuesit	Nr.i faqes	Numri identifikues i artikullit
1.				

Të dhënat e deklaruara në ofertën teknike duhet të korespondojnë me të dhënat për artikujt në katalogët/skedat teknike të dorëzuara. Moskorespondimi i këtyre të dhënave do të sjellë pavlefshmëri të ofertës.

5. Operatori ekonomik duhet të dorëzojë për shtyllat (zëri 30-41 tek tabela e shtojcës 6) dhe për ndriçuesit (zëri 1- 26 tek tabela e shtojcës 6), Çertifikatat e Konformitetit (CE) referuar shtojcës 5 “Formulari i specifikimeve teknike”. Për shtyllat (zëri 30 - 41 tek tabela e shtojcës

- 6) operatori ekonomik duhet të dorëzojë dhe çertifikatën për galvanizimin sipas normave të përcaktuara në shtojcën 5 “Formulari i specifikimeve teknike”.
6. Operatori ekonomik duhet të dorëzojë për zërin “Ndriçues rrugor LED 10.000 lumen (Smart)” dhe “Ndriçues dekorativ LED 8000 lumen (Smart)” çertifikatën e konformitetit të kontrollit sipas normave të përcaktuara në shtojcën 5 “Formulari i specifikimeve teknike” si dhe çertifikatat/raportet e testimit për shkallën e mbrojtjes, izolimin dhe bojën e ndriçuesve sipas normave të përcaktuara në shtojcën 5 “Formulari i specifikimeve teknike”.

**Argumentim:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pika 6/c e nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtyre kritereve (pika 3-6) kërkohet që operatorët ekonomikë të faktojnë specifikimet teknike dhe AK të verifikojë pajtueshmërinë këtyre specifikimeve me ato të kërkuara në DST.

7. Operatori ekonomik duhet të dorëzojë mostrat e materialeve të pasqyruara në tabelën e mëposhtme, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve dhe Ndriçimit Publik në datën dhe orën e hapjes së ofertave. **Mosparaqitja e tyre përbën kusht për s’kualifikim.**

Nr.	Përshkrim Ndriçuesi	Njësia	Sasia
1	Ndriçues rrugor LED 6300 Lumen	copë	1
2	Ndriçues rrugor LED 9000 Lumen	copë	1
3	Ndriçues rrugor LED 14000 Lumen	copë	1
4	Ndriçues rrugor LED 10000 Lumen (Smart)	copë	1
5	Ndriçues rrugor LED 8000 Lumen (Smart)	copë	1
6	Ndriçues rrugor Solar LED 6000 Lumen Hybrid	copë	1
7	Ndriçues dekorativ konik LED 4600 Lumen	copë	1
8	Ndriçues rrugor dekorativ projektor LED 6200 Lumen	copë	1
9	Ndriçues projektor fasada WallWasher LED RGB 6300 Lm	copë	1
10	Ndriçues dekorativ me mbulëse rrethore LED 5700 Lumen	copë	1
11	Ndriçues + Shtylle Dekorative 3-Degesh	copë	1
12	Ndriçues dekorativ rrethor 80cm LED 6200 Lumen	copë	1

**Argumentim:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 6, gërma a) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Vendosija e këtij kriteri, referuar edhe legjislacionit në fuqi i shërben autoritetit kontraktor për të vlerësuar nëse një operator ekonomik ka kapacitete për të ofruar produktin e kërkuar si dhe për të verifikuar përmbushjen e specifikimeve teknike të këtyre mallrave. Konkretisht, mostrat e të gjithë ndriçuesve do kalojnë për kontroll të hollësishme mekanike dhe do të testohen si mëposhtë :

- 1- Do të verifikohet përputhshmëria e përmasave të skedës me disa nga shtyllat aktuale në përdorim

- 2- Per ndricuesit te cilet perdoren si zevendesues te pajisjeve te djegura do te shikohet perputhshmeria me ndricueset ekzistues.
- 3- Per ndricuesin solar do te behet nje analize e vendosjes e baterise nese eshte i inkorporuar ne trup, pasi nuk ekziston mundesia e vendosjes se jashtme te baterise.
- 4- Per ndricuesit 4 dhe 5 do te testohet pershtatja e tyre me sistemin aktual online të monitorimit dhe menaxhimit të rrjetit të ndriçimit publik qe perdor Drejtoria per monitorimin e ndricuesve.
- 5- Per te gjithë ndricueset ku eshte kerkuar dimerimi do te shikohet driveri nese e mundeson kete zgjidhje nepermjet lidhjes.

## **II. Argumentimi i specifikimeve teknike**

Specifikimet teknike janë hartuar nga grupi i posaçëm, i cili është ngritur me Urdhër të Titullarit për hartimin e specifikimeve të teknike në përputhje me nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Specifikimet teknike të mallrave objekt prokurimi janë hartuar duke u diktuar nga nevoja për mallra të cilat shërbejnë për mirëmbajtjen e rrjetit të ndriçimit publik ekzistues dhe vijimin me instalime të reja sipas objektivave të AK, konkretisht si më poshtë vijon:

1. Referuar instalimeve ekzistuese, për të cilat nuk është e mundur zëvendësimi total i tyre për shkak të kostos, do të realizohet mirëmbajtja e tyre duke ndjekur modelet e mëparshme të instaluara dhe zëvendësimi i vetëm i pjesëve të defektuara apo të djegura.
2. Modelet janë perzgjedhur për t’iu pershtatur anës estetike dhe uniformitetit të të gjithë ndriçuesve ekzistues. Nese nuk do të vendosnim të njëjtet modele si ato ekzistuese do të shtohet numri i modeleve, çka do të vështiresonte dhe do të rriste koston e mirëmbajtjes.
3. Specifikimet janë hartuar për të rritur eficienten, efikasitetin dhe për të ulur konsumin e energjisë, si dhe për të rritur jetegjatesinë e ndricuesve, bazuar kjo në kriteret ligjore dhe teknike të vlerësimit të cilësive si certifikata ISO, CE etj apo edhe standarte të tjera.
4. Kërkesa për vendosjen e ndricuesve LED është bërë duke pasur parasysh që janë me ekonomik në konsum dhe jetegjatesinë me të madhe nga llampat inkandeshente.
5. Shtyllat dhe krahët janë kërkuar sipas standarteve teknike për një instalim korrekt, bazuar në dizajnin e shtyllave të instaluara deri me tani, shoqeruar dhe me kërkesat dhe dokumentacionin ligjor e teknik për standartet e cilësive që duhet të përmbushen.

Specifikimet teknike shprehin tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe në përputhje të plotë me funksionet e kërkuara nga Autoriteti.

*Specifikimet teknike gjenden në shtojcën 5 të Dokumentave Standarte të Tenderit.*

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në*

*përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.***

*Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.*

### **NJËSIA E PROKURIMIT**